



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
EKIPI TEMATIK PËR MONITORIMIN E STRATEGJISË
NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË PËR TË MITUR
2022-2026

5962
Nr. __ prot, __

Tiranë më 18. 11. 2024

Vendim

Nr. 67, datë 18. 11. 2024

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR
2023 DHE JANAR-QERSHOR 2024, PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE
TË DREJTËSISË PËR TË MITUR**

Në mbështetje të vendimit Nr. 892, datë 27.12.2022 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022-2026, Planit të Veprimit dhe të Pasaportës së Indikatorëve”, urdhrit të Kryeministrit Nr. 90, datë 01.08.2023 “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”, Ekipi Tematik për monitorimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur,

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të Monitorimit për periudhën janar-dhjetor 2023 dhe janar-qershor 2024, për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur dhe të Planit të saj të Veprimit.
2. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë të publikojë Raportin e Monitorimit për periudhën janar-dhjetor 2023 dhe janar-qershor 2024, në faqen zyrtare të saj.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

ZËVENDËSMINISTËR

Klajd Karameta





RAPORT MONITORIMI JANAR – QERSHOR 2024

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E DREJTËSISË PËR TË MITUR 2022-2026

[Nëntor 2024](#)

www.drejtesia.gov.al

TABELA E PËRMBAJTJES

SHKURTIME.....	3
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	5
II. REALIZIMI I QËLLIMEVE TË POLITIKËS PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2024.....	8
III. METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT DHE PERFORMANCËS.....	10
➤ Koordinimi institucional për hartimin e raportit të monitorimit dhe performancës.....	10
➤ Periodiciteti i hartimit të Raportit të Monitorimit dhe Performancës	11
➤ Fazat e ndjekura për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës	11
➤ Metodologjia e analizimit të të dhënave për raportin e monitorimit dhe performancës.....	12
➤ Konsultimi publik i raportit të monitorimit dhe performancës.....	12
IV. VLERËSIMI I ARRITJES SË QËLLIMEVE TË POLITIKËS KUNDREJT MASAVE DHE AKTIVITETEVE.....	18
V. NIVELI I REALIZIMIT NË TOTAL PËR 64 MASA NË PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2024.....	33
VI. VLERËSIMI I SFIDAVE, HAPAT NË VIJIM.....	34

SHKURTIME

AKCESK	Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AMA	Autoriteti Mediave Audiovizive
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjen Vendore
AP	Avokati i Popullit
AS	Akademia e Sigurisë
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
BE	Bashkimi Evropian
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DM	Drejtësia për të Mitur
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
DPAP	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPSHP	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
DVP	Drejtoria Vendore e Policisë
DHASH	Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë
DHKN	Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve
IAL	Institucione të Arsimit të Lartë
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
INSTAT	Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë
IDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KDPM	Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur

KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
KLGG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KM	Këshilli i Ministrave
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSHRF	Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NJMF	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PR	Parlamenti Rinor
SDM 2022-2026	Strategjia e Drejtësisë për të Mitur dhe Plani i Veprimit 2022-2026
SIDhDPM	Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur
QPKMR	Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve
RSH	Republika e Shqipërisë
RTSH	Radio Televizioni Shqiptar
SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
SHM	Shkolla e Magjistraturës
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
TdH	Terre des Homes
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UP	Urdhri i Psikologut
UPS	Urdhri i Punonjësit Social

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Legjislacioni shqiptar bazohet në parimet e drejtësisë miqësore për fëmijët, e cila ka në thelb të saj garantimin e respektit dhe efektivitetin e zbatimit të të gjithë të drejtave të fëmijëve, në nivelin më maksimal të mundshëm. Kuadri ligjor synon të garantojë elementët e domosdoshëm të drejtësisë miqësore të tillë si: aksesueshmëria, përshtatshmëria, efektiviteti në raport të drejtë me nevojat dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve. Parime të tilla si pjesëmarrja dhe informimi, interesi më i lartë i fëmijës, dinjteti, mbrojtja nga diskriminimi, shteti i së drejtës, qëndrojnë në themel të kuadrit ligjor shqiptar. Drejtësia miqësore përfshin të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të drejtën për pjesëmarrje dhe për të kuptuar procedurat, të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare si dhe të integritetit dhe dinjtetit.

Strategjia e Drejtësisë për të Mitur 2022-2026 dhe Plani i saj i Veprimit është strategjia e dytë në fushën e drejtësisë për të mitur. Dokumentet e saj strategjike përfshirë si, Plani i Veprimit dhe Pasaporta e Indikatorëve, u miratuan në me VKM Nr. 892, datë 27.12.2022 dhe zbatimi i saj nisi menjëherë.

Zbatimi i “SDM 2022-2026” është arritur përmes një sistemi monitorimi dhe vlerësimi për të verifikuar progresin në plotësimin ose jo të objektivave specifike dhe masave të vendosura në Planin e Veprimit.


Rrjeti Ndërinstitucional në nivel qendror për zbatimin e strategjisë është grupi ku diskutohen çështje të ecurisë së zbatimit të objektivave dhe masave të “SDM 2022-2026” me qëllim bashkëpunimin ndërinstitucional me grupet e interesit. Rrjeti Ndërinstitucional në nivel qendror, drejtohet nga Ministria e Drejtësisë dhe ka në përbërje të tij përfaqësues nga institucionet e tjera ligjzbatuese, që janë përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e treguesve në kompetencën e tyre. Ky rrjet mbështetet në veprimtarinë e tij nga Sekretariati Teknik (ST), i cili do të drejtohet nga Ministria e Drejtësisë.

SDM 2022-2026 parashikon për zbatim gjatë 5 viteve të implementimit të saj, 4 Qëllime Politike, 13 Objektiva Specifike dhe 64 masa për të kontribuar në performancën e 45 indikatorëve cilësorë dhe sasiorë.

Lidhur me përmbushjen e objektivave të Qëllimit të Parë Politik për “Parandalimin e veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre përmes edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimi të shoqërisë dhe fëmijëve” konstatohet se:

Nga secili institucion bashkëpërgjegjës përfshirë edhe bashkitë e vendit, janë shënuar disa arritje të rëndësishme, pozitive dhe inkurajuese përmes edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimi të shoqërisë dhe fëmijëve nëpërmjet zhvillimeve të aktiviteteve dhe fushatave ndërgjegjësuese për parandalimin e veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre.


Referuar aktiviteteve të kryera përgjatë periudhës raportuese, fëmijët në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme kanë marrë informacione për të drejtat e fëmijës, parandalimin e veprave penale ndaj tyre si dhe të drejtën për të pasur në çdo kohë qasje në shërbimet e drejtësisë miqësore për çdo fëmijë. Ndërkohë është punuar edhe për promovimin dhe fuqizimin e programeve, prezenca virtuale e fëmijëve/të rinjve online, krijimi i hapësirave të sigurta dhe mbrojtjes ndaj bullizimit online. Po vijohet edhe me fuqizimin në shkolla, një masë e



cila është realizuar në bashkëpunim me oficerët e policisë, mësuesit, specialistët e Policimit në Komunitet dhe me punonjësit e Shërbimit psiko-social të shkollave. Institucionet bashkëpërgjegjëse (MSHMS, QPKMR, DNJF DHE SHSSH) kanë përditësuar informacionin online, me një gjuhë miqësore për të drejtat dhe shërbimet e drejtësisë miqësore për fëmijë. Gjithashtu, institucionet (AP, KMD, KDIMDHP) kanë ndërmarrë fushata ndërgjegjëse me qëllim parandalimin e viktimizimit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe diskriminimin e fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin. Bazuar në raportimin e bashkive raportuese (Lushnjë, Dibër, Lezhë, Korçë, Pogradec, Tiranë, Vlorë, Shkodër, Kamëz), janë mbajtur takime informuese dhe ndërgjegjëse në komunitet dhe në disa njësi administrative por edhe në shkolla për të informuar prindërit dhe fëmijët në rrezik braktisje të arsimit të detyruar, në lidhje me parandalimin e kryerjes/përfshirjes në vepra penale ose nga viktimizimi prej tyre. Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve ka zhvilluar takime në shkolla për të promovuar programin e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimin në qytetet Elbasan, Durrës, Tiranë dhe Vlorë.

Lidhur me përmbushjen e objektivave të Qëllimit të Dytë Politik “Një kuadër ligjor, institucional dhe me profesionistë që mundësojnë një drejtësi miqësore për çdo fëmijë” konstatohet se:

Në kuadër të mbrojtjes dhe të drejtave të fëmijëve, Avokati i Popullit ka adresuar 14 rekomandime si dhe 10 nënrekomandime për garantimin e të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin. Sa i takon arritjes së objektivit në lidhje me koordinimin dhe bashkërendimin mes institucioneve me qëllim forcimin e kapaciteteve të




profesionistëve që punojnë me dhe për fëmijët, janë zhvilluar trajnime në bashkëpunim edhe me organizata të ndryshme. Në bashkëpunim me UNICEF, janë zhvilluar trajnime të shumta në vend, në lidhje me teknikat miqësore të intervistimit të të miturve, viktime të dhunës fizike dhe abuzimit seksual. Gjithashtu, Shkolla e Magjistraturës, ka kryer trajnime për magjistratët në kuadër të drejtësisë miqësore për fëmijë në çështjet penale, civile, familjare dhe administrative ku fëmija merr pjesë ose vendimmarrja e tyre ndikon te fëmija.

Për periudhën Janar-Qershor 2024, ka arritje në drejtim të forcimit të rolit koordinues të Ministrisë së Drejtësisë me institucionet e linjës për çështjet që lidhen me fëmijët dhe mbledhja, përpunimi dhe publikimi i statistikave për çështjet civile, familjare, administrative dhe penale ku fëmijët janë pjesë ose vendimmarrja ndikon te fëmijët, bazuar në standardet ndërkombëtare të miratuara në fushë. Gjatë kësaj periudhe, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka bërë të mundur ndarjen për çështjet civile, familjare, administrative dhe penale ku fëmijët janë pjesë ose vendimmarrja ndikon tek fëmijët, ku kanë përfituar në total 146 të mitur, ku 87 raste janë çështje administrative, 15 penale, 24 civile dhe 20 janë të papërcaktuar se cilës lloj çështje i përkasin.

Gjithashtu, vazhdon edhe raportimi i rregullt nga Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve mbi funksionimin e Sistemit të Integruar, ku gjenerohen rastet e hedhura nga institucionet përdoruese në sesionin “Të Mitur”, të cilat rezultojnë në 5,340 raste të hedhura në sistem.

Lidhur me përmbushjen e objektivave të Qëllimit të Tretë Politik “Garantimin e qasjes në çdo kohë në drejtësinë miqësore për çdo fëmijë” konstatohet se:

Janë ndërmarrë hapa të mëtejshëm mbi informimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit të subjekteve të ligjit “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, për të drejtat e tyre për ndihmë dhe akses në institucione, përfshirë dhe fëmijët. Gjithashtu, gjatë vitit 2024, janë zhvilluar trajnime dhe praktika 2-mujore të studentëve të angazhuar pranë Klinikave të Ligjit, të cilët janë informuar mbi ofruesit e ndihmës juridike falas, kushtet për përfitim të ndihmës juridike falas, kategoritë përfituese si dhe procedurën e dhënies së ndihmës juridike falas duke përfshirë edhe të miturit. Në këto trajnime fokus të veçantë kanë marrë të miturit në lidhje me mënyrën e pritjes dhe evidentimit të problematikave, për tu bërë e mundur realizimi i të drejtave të tyre, si përfitues të drejtëpërdrejtë të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.



Janë përmirësuar dukshëm shërbimet për fëmijët në kontakt/konflikt me ligjin të ofruara në mjedise miqësore në komisaritet e policisë. Gjatë kësaj periudhe u bë e mundur përgatitja nga

UNICEF e manualit mbi "Teknikat Shkencore të Intervistimit me të mitur", e cila do t'iu vijë në ndihmë të gjithë punonjësve të policisë që merren me çështjet e fëmijëve.

Këshilli i Lartë Gjyqësor raporton se të gjitha gjykatat që nuk janë prekur nga harta e re gjyqësore janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme duke përfshirë mjetet të cilat garantojnë zhvillimin e seanceve me audio/video konferencë që përdoren në funksion të shmangies së kontakteve dhe ballafaqimin e fëmijës me autorin e veprës penale. Prokuroria e Përgjithshme sjell në vëmendje përmirësimin e mëtejshëm të mjediseve miqësore dhe të përshtatshme për fëmijët në prokurori, në kuadër të hartës së re gjyqësore ashtu edhe në arritjen e shërbimeve në përputhje me standardet ndërkombëtare.


Lidhur me përmbushjen e objektivave të Qëllimit të Katërt Politik “Drejtësia penale që mundëson parandalimin e ripërfshirjes së fëmijës në kryerjen e veprave penale, rishoqërimin dhe riintegrimin e fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin” konstatohet se:

Janë zhvilluar trajnime për magistratët në kuadër të programeve në lidhje me drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin. Në zbatim të planit të këshillimit me fëmijën dhe familjen si një masë alternative e mundshme për shmangien nga ndjekja penale rezultoi se nga të dhënat statistikore të prokurorive kjo masë është aplikuar ndaj 7 të miturve. Ndërkohë, është arritur edhe fuqizimi i programeve të formimit profesional, edukues, rehabilitues dhe rintegruues për të miturit nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive duke ofruar rreth 107 programe.

Gjatë periudhës së raportimit, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të


Miturve dhe të Rinjve ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me 3 OJF dhe institucione që veprojnë në fushën e drejtësisë penale për të mitur me qëllim riintegrimin e të miturve pas kryerjes së dënimit.

Referuar fuqizimit të bashkëpunimit mes Shërbimit të Provës dhe organeve të qeverisjes vendore janë nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi. Gjatë 6 muajve të parë të vitit 2024 janë realizuar 15 fushata informuese me nxënësit e arsimit parauniversitar për përparësitë dhe përfitimet e programeve rehabilituese/ri-integruese për një përzgjedhje sa më efektive të programit e cila do të sigurojë një riintegrim të qëndrueshëm të fëmijës, si dhe janë trajtuar 25 raste të të miturve të liruar nga IM Kavajë, nga të cilët: 9 të mitur kanë vijuar ndjekjen e arsimit dhe kurseve profesionale. Përsa i përket përdorimit të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur në konflikt me ligjin nga të gjithë institucionet përdoruese, evidentohen problematika mbi mosfunksionimin total të tij të herëpashershëm dhe janë marrë masa për përmirësimin e sistemit.




II. REALIZIMI I QËLLIMEVE TË POLITIKËS PËR PERIUdhËN JANAR-QERSHOR 2024

Niveli i Realizimit: Qëllimi Politik I




■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara
■ Të pazbatuara

Niveli i Realizimit: Qëllimi Politik II




■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara

Niveli i Realizimit: Qëllimi Politik III



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara

Niveli i Realizimit: Qëllimi Politik IV



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara

III. METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT DHE PERFORMANCËS

Metodologjia e Raportit të Monitorimit, përshkruan procesin e ndjekur gjatë hartimit të raportit dhe ka si qëllim kryesor të mundësoj udhëzimet e nevojshme për lehtësimin në kuptueshmërinë e tij, si dhe të orientohet drejt prezantimit të rezultateve kryesore për të nxjerrë në pah arritjet, sfidat dhe rekomandimet e adresuara për përmirësim. Për të siguruar një proces monitorimi bazuar në arritje konkrete, Ministria e Drejtësisë realizon komunikime intensive me përfaqësuesit e strukturave të përfshira në Planin e Veprimit, me qëllim prezantimin e drejtë dhe të qartë të rezultateve dhe problematikave të hasura gjatë periudhës së raportimit. Kështu, gjatë periudhës hartuese, është mbajtur një komunikim i vazhdueshëm (verbal dhe zyrtar) në varësi të specifikave për plotësimin e dokumentave raportues me disa prej institucioneve të përfshira në strategji, me qëllim evidentimin e rasteve të suksesit, të cilat kanë sjellë rezultate të dukshme në veprimtarinë e tyre, gjithashtu identifikimin e sfidave, problematikave dhe komponentëve të cilët kanë ndikuar apo penguar progresin apo zbatimin e aktiviteteve të parashikuara.

Gjithashtu, gjatë periudhës Janar - Qershor 2024, me mbështetjen e institucioneve bashkëpërgjegjëse në raportim është mbledhur informacion mbi zbatimin e masave dhe aktiviteteve në Planin e Veprimit si dhe indikatorëve në Pasaportën e Treguesve.

Ky raportim përfshin masat të cilat fillojnë zbatimin e tyre në vitin 2024 si dhe masat të cilat raportohen rregullisht në mënyrë vjetore.

Ministria e Drejtësisë, harton raporte gjashtëmujore dhe vjetore për monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike, të cilët prodhojnë informacion të nevojshëm për politikëbërësit mbi progresin e zbatimit të masave që janë parashikuar në planin e veprimit të SDM-së për vitet e ardhshme, raporte të cilat publikohen në faqen zyrtare të MD-së.

Ministria e Drejtësisë ka hartuar raportin e monitorimit dhe të performancës për periudhën përkatëse sipas manualit të hedhjes së të dhënave në sistemin IPSIS miratuar me vendimin nr. 290, datë 11.4.2020 "Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS).

➤ Koordinimi institucional për hartimin e raportit të monitorimit dhe performancës

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 128, dt. 08.11.2021 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë", është ngritur Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, pranë Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues si dhe hartimin e Raporteve të Monitorimit të Strategjive. Ky sektor kryen koordinimin me të gjitha institucionet përgjegjëse, si dhe më pas vijon

me hartimin e raportit të monitorimit. Raporti i monitorimit të dokumentit strategjik (SDM 2022-2026) për periudhën 1 janar deri më 30 qershor 2024, është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga institucionet përgjegjëse dhe kontributore të planit të veprimit.

➤ **Periodiciteti i hartimit të Raportit të Monitorimit dhe Performancës**

Ministria e Drejtësisë, harton raporte gjashtë mujore dhe vjetore për monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike, të cilët prodhojnë informacion të nevojshëm dhe në kohë për politikëbërësit mbi progresin e zbatimit të masave që janë parashikuar në planin e veprimit të SDM (2022-2026) raporte të cilat publikohen në linkun: www.drejtesia.gov.al/strategjia-ndersektoriale-2/.

➤ **Fazat e ndjekura për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës**

Fazat që janë ndjekur për përgatitjen dhe konsolidimin e raportit të monitorimit dhe performancës, paraqiten si më poshtë:

- Kërkesa për kontribut në rrugë elektronike u dërgua në datë 10 korrik 2024 tek të gjitha institucionet raportuese në përputhje me standardet e sistemit IPSIS dhe Parimet e Mirëqeverisjes;
- Kërkesa shtesë për kontribut nga institucionet kontribuese në datën 22 korrik 2024. Kjo për arsye se disa institucione nuk kishin dërguar inpute brenda afatit të përcaktuar;
- Kërkesa për kontribut shtesë nga institucionet kontribuese në datën 26 korrik 2024. Kjo për arsye se inputet e dhëna nuk ishin në përputhshmëri me kërkesat e masave dhe objektivave;
- Hartimi i draftit të parë të raportit të performancës në datën 9 tetor 2024;
- Dërgimi për konsultim publik në datën 23 tetor 2024;
- Mbledhja e komenteve/sugjerimeve/dakordësisë, mbi masat/aktivitetet nga konsultimi publik dhe reflektimi i tyre në Raportin e Monitorimit 6-mujor (31 tetor 2024);
- Zhvillimi i takimit të Ekipit Tematik në kuadër të prezantimit dhe miratimit të draft Raportit të Monitorimit për periudhën janar-qershor 2024 (18 nëntor 2024);
- Publikimi i Raportit 6 mujor të Monitorimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë;
- Dërgimi i procedurave të mbledhjes (minutat e takimit, konkluzionet operacionale, raporti i konsultimit publik) dhe paketa finale, së bashku me linkun e publikimit për njohje SASPAC datën.

➤ Metodologjia e analizimit të të dhënave për raportin e monitorimit dhe performancës

Raporti shpreh qartë vlerësimin e arritjeve kryesore duke përdorur grafikë, analiza të thelluara, edhe vizualisht përmes tabelave. Gjithashtu paraqitet qartë identifikimi i shkallës së performancës për Qëllimet e Politikave dhe Objektivet Specifikë.

Analiza mbi progresin e realizimit të Qëllimeve Politike ndjek një qasje të strukturuar. Progresi lidhur me secilin Qëllim Politik është analizuar në përgjithësi sipas Objektivave Specifikë (OS) përkatës. Në vijim, për secilin OS është paraqitur një përmbledhje e rezultateve sasiore dhe cilësore të zbatimit të masave përkundrejt kryerjes së veprimeve për realizimin e tyre nga institucionet përgjegjëse, analiza e risqeve dhe veprimeve për adresimin e tyre (sipas rastit) dhe analiza e treguesve të performancës, nëse kjo ka qenë e mundur mbi bazën e të dhënave të paraqitura nga institucionet përgjegjëse. Prezantimi i rezultateve mbi zbatimin e masave ndjek numërimin e Planit të Veprimit dhe është prezantuar me sfond me ngjyrë sipas nivelit të zbatimit (të zbatuara plotësisht/ të zbatuara pjesërisht/ të pazbatuara).

Disa masa rezultojnë të pazbatueshme dhe janë paraqitur me sfond të bardhë. Ato përfshijnë: (i) masat afati i zbatimit i të cilave fillon pas periudhës aktuale të raportimit; (ii) masa të cilat nuk mund të zbatohen nga institucioni raportues për arsye të cilat nuk varen nga institucioni (p.sh. mungesë e kompetencave).

➤ **Përcaktimi i nivelit të zbatimit të masave** është ai i raportuar nga secili institucion përgjegjës, dhe është evidentuar në kontributet e përcjella prej tyre mbi çdo masë të përcaktuar. Shkalla e zbatimit të masave është përcaktuar si më poshtë:

- **E zbatuar**: masa e cila është përmbushur plotësisht;
- **Pjesërisht e zbatuar/Në proces**: masa e cila në periudhën e raportimit ka pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijon të jetë në zbatueshmëri;
- **E pazbatuar**: masa e cila nuk ka pasur zhvillim dhe progres për periudhën raportuese.

Përcaktimi i nivelit të realizimit të OS është përlogaritur si mesatarja e përqindjes së zbatimit të masave përkatëse. Analiza në nivelin e mesatares së përqindjes së zbatimit të masave pasqyron në mënyrë më të drejtpërdrejtë arritjet lidhur me Objektivat Specifikë në periudhë janar-qershor 2024.

Përcaktimi i nivelit të realizimit të Qëllimeve të Politikave është përlogaritur si mesatarja e përqindjes së realizimit të Objektivave Specifikë përkatës.

➤ Konsultimi publik i raportit të monitorimit dhe performancës

Një komponent i rëndësishëm i mirëqeverisjes që ndërlidhet me rritjen e cilësisë së llogaridhënies dhe transparencës së institucioneve publike si dhe forcimin e demokracisë është procesi i konsultimit publik. Tashmë korniza rregullatore për konsultimin publik është unifikuar dhe ka ndikuar në përmirësimin e transparencës dhe cilësisë së politikave. Prioritare mbetet përfshirja aktive e publikut dhe shoqërisë civile në proceset e politikbërjes. Në përputhje me kriteret ligjore për konsultimin publik, pas hartimit të draft raportit, Ministria e Drejtësisë e dërgoi në datën 23 tetor 2024 dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe e publikoi draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve, në faqen e internetit www.drejtesia.gov.al, në menu www.drejtesia.gov.al/konsultime/ . Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë reflektoji komentet/sugjerimet relevante mbi draft raportin e monitorimit dhe vijoi me zhvillimin e një takimi të dedikuar, në kuadër të diskutimit të analizës së kryer, gjetjeve të raportit, vlerësimin të qëllimeve të politikës në prezencë të të gjithë institucioneve zbatuese dhe raportuese të planit të veprimit. Pas miratimit të raportit, Ministria e Drejtësisë publikoi në faqen e saj zyrtare raportin në gjuhën Shqipe.


IV. VLERËSIMI I ARRITJES SË QËLLIMEVE TË POLITIKËS KUNDREJT MASAVE DHE AKTIVITETEVE

Qëllimi i Parë i Politikës


“Parandalimi i veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre, përmes edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë dhe fëmijëve”.

Qëllimi i Parë i Politikës: 12 masa

12 masa të zbatueshme për 2024



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara
■ Të pazbatuara




Gjatë vitit 2024, janë bërë hapa të mëtejshëm drejt arritjes së Qëllimit të Parë të Politikës. Nga 12 masat e zbatueshme për vitin 2024, 7 masa u zbatuan plotësisht, 4 masa u zbatuan pjesërisht dhe 1 masë e pazbatuar. **59%** e masave janë realizuar plotësisht për periudhën raportuese. Plani i Veprimit parashikon 10 (dhjetë) masa për O.S 1.1 dhe 2 (dy) masa për O.S 1.2. Masat ndjekin numërimin e planit të veprimit dhe janë me sfond me ngjyrë sipas nivelit të arritjes (*të zbatuara plotësisht/të zbatuara pjesërisht/të pazbatuara*).

➤ Objektivi Specifik 1.1.

“Informim/edukim/ndërgjegjësim në qarqet e targetuara për parandalimin e veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre dhe qasja në drejtësinë miqësore në çdo kohë për çdo fëmijë”.

Plani i Veprimit për Objektivin 1.1 parashikon 10 masa, prej të cilave 7 masa janë zbatuar plotësisht, 2 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 1 masë është e pazbatuar. **70%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 1.1: 10 MASA



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara ■ Të pazbatuara

Arritjet kryesore për periudhën raportuese:

- ✚ Ministria e Arsimit dhe Sportit ka zhvilluar veprimtari njohëse dhe informuese mbi të drejtat e fëmijëve në bashkëpunim me mësuesit dhe oficerët e sigurisë në shkolla gjatë periudhës Janar-Qershor 2024. Aktivitetet përfshijnë orë ndërgjegjësuese me nxënës dhe takime me prindër për të përmirësuar sigurinë në shkolla, mirëqenien e fëmijëve dhe parandalimin e braktisjes së arsimit. Informimi i vazhdueshëm ka kontribuar në rritjen e përqindjes së nxënësve që ndjekin arsimin e detyruar. Gjithashtu, është rritur ndjeshëm numri i prindërve që marrin informacionin online në faqen zyrtare të shkollës.
- ✚ Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka zbatuar projektin "Parandalimi i dhunës dhe i krimit tek të rinjtë përmes sensibilizimit dhe edukimit ligjor mes bashkëmoshatarësh" në Bashkitë Kuçovë, Lezhë dhe Sarandë.
- ✚ Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike dhe Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës kanë planifikuar 27 aktivitete për vitin 2024. Nga janari në maj 2024 u realizuan 4 trajnime dhe 8 takime ndërgjegjësuese në disa qytete.
- ✚ Avokati i Popullit dhe Komisioneri i Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve, kanë organizuar 20 aktivitete në shkolla për të promovuar mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe për të rritur njohuritë e nxënësve, prindërve dhe stafit pedagogjik.
- ✚ Në kuadër të ditëve të shënuara për të drejtat e fëmijëve, janë organizuar aktivitete ndërgjegjësuese me përmbajtje të përshtatur për moshën e fëmijëve, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës. Në mars 2024 (MSHMS, MEKI, MAS dhe ANAD) nënshkruan një marrëveshje për të përmirësuar cilësinë e edukimit dhe për të siguruar shërbime për individët që nuk dëgjojnë, përfshirë interpretimin e gjuhës së shenjave dhe identifikimin e hershëm të fëmijëve që nuk dëgjojnë. Gjatë periudhës Janar-Qershor, janë certifikuar instruktorë të gjuhës së shenjave për të siguruar që shërbimet të ofrohen në këtë gjuhë.
- ✚ Shërbimi Social Shtetëror ka krijuar një manual për sesionet e edukimit dhe informimit për fëmijët në institucionet rezidenciale të kujdesit, duke përdorur një gjuhë miqësore. Nga janari në qershor, janë zhvilluar 4 sesione edukimi në lidhje me të drejtat e fëmijëve dhe

parandalimin e veprave penale në Shtëpinë e Fëmijës në Tiranë dhe në Sarandë, ku janë trajnuar 50 fëmijë dhe 23 punonjës të institucioneve.

- ✚ Nga monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së zbatimit të programeve informuese, edukuese dhe ndërgjegjësuere për fëmijët që Autoriteti i Mediave Audiovizive kryen, rezultojn se gjatë kësaj periudhë: 38% e ankesave kanë pasur objekt të drejtat e fëmijëve; në 69% të rasteve të sipërpërmendura është dërguar tërheqje vëmendjeje identifikim indirekt i fëmijës viktimë ose dëshmitar i një ngjarjeje të dhunshme; në një rast është vënë gjobë (emision me skenë të papërshtatshme në një orar që ndiqet nga fëmijët).
- ✚ Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka zhvilluar aktivitete ndërgjegjësimi me fokus në shërbimet e drejtësisë miqësore për fëmijët në Korçë, Shkodër, Lezhë dhe Fier. Në këtë periudhë, Komisioneri ka organizuar 17 dalje në media për të adresuar shkaqet e diskriminimit dhe për të promovuar barazinë. Përveç kësaj, ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme për të forcuar bashkëpunimin me institucione shtetërore dhe organizata kombëtare e ndërkombëtare. Gjithashtu, KMD ka publikuar botimin “Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi – përmbledhje për fëmijë”, një përpyetje e përbashkët me UNICEF në Shqipëri dhe mbështetur nga Ambasada e Norvegjisë. Ky botim është ndihmues për fëmijët, prindërit, mësuesit dhe drejtuesit e institucioneve arsimore në adresimin e shkaqeve të diskriminimit dhe promovimin e barazisë. Ai është i aksesueshëm në shkollë dhe online, për të ofruar udhëzime dhe për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve.
- ✚ Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka zhvilluar një Modul Trajnues për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë në internet, i cili do të përdoret nga mësuesit dhe nxënësit për të përmirësuar përdorimin e rrjeteve sociale dhe sigurinë online. Ky dokument është ndërtuar duke u bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe është përfshirë në kurrikulën arsimore në bashkëpunim me institucionet përkatëse. Zyra e Komisionerit ka organizuar një sesion trajnues për mësuesit duke trajtuar legjislacionin mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe sfidat e teknologjisë dhe digjitalizimit. Aktiviteti përfshiu nxënës dhe mësues të tjerë, duke nxitur një bisedë interaktive. Trajnimi u shtri në qytete të ndryshme të Shqipërisë dhe përfshiu 20 shkollë të mesme. Në fund, Zyra e Komisionerit nxori një “Rekomandim Unifikues” për mbrojtjen e të dhënave personale në arsimin e mesëm, duke evidentuar problemet që duhet të adresohen nga institucionet arsimore. Për të prezantuar rezultatet, Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me OSBE organizoi një aktivitet përmblyës me pjesëmarrës nga sektori arsimor dhe familjar, ku u theksua rëndësia e bashkëpunimit për një edukim cilësor të brezit të ri.
- ✚ Bashkia Lushnjë, ka bashkëpunuar me Zyrën e Shërbimit të Provës, me të cilën janë trajtuar 8 raste për të rinjtë në konflikt me ligjin për periudhën janar-qershor 2024. Në të gjitha rastet është bërë e mundur forcimi dhe konsolidimi në arritjen e fushës së drejtësisë penale për të mitur me qëllim për ti mbajtur ata larg nga ripërfshirja në kriminalitet dhe viktimizimin e tyre. Janë zhvilluar takime informuese edhe me prindër të fëmijëve për tu informuar dhe për tu ardhur në ndihmë me informacione mbi temat si: interneti i sigurt, pasojat ligjore dhe psikologjike të veprimeve të fëmijëve në raste të cilat mund të jenë në konflikt me ligjin.
- ✚ Bashkia Berat, ka zhvilluar 4 takime GTN për rastet e mbrojtjes dhe 12 takime SPZ për raste të fëmijëve të braktisur, të mitur të dyshuar për VMT dhe në konflikt me ligjin. Në Qendrën Komunitare janë organizuar takime mujore me prindër nga grupet vulnerabël për prindërimin pozitiv dhe mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi online.

- ✚ Bashkia Dibër, është pjesë e një programi e cila mbështetet nga fondi i Ministrisë së Arsimit dhe targeton fëmijët në rrezik braktisje për tu mbështetur, për të parandaluar braktisjen e arsimit dhe për të parandaluar përfshirjen e tyre në vepra penale në të cilën janë përfshirë rreth 150 fëmijë. Për periudhën janar-qershor 2024 janë zhvilluar: 2 takime me stafin psiko social në shkolla, 1 takim me Drejtorinë Rajonale të Policisë, 3 takime me organizata. Takimet me Administratorët Shoqëror të Njësive kryhen çdo tre mujor dhe diskutohet në lidhje me parandalimin e kryerjes/përfshirjes në vepra penale.
- ✚ Bashkia Kamëz, ka zhvilluar trajnime dhe aktivitete që kanë në qendër rehabilitimin dhe risocializimin e fëmijëve në konflikt me ligjin.
- ✚ Bashkia Korçë, ka hartuar fletëpalosje për ndërgjegjësimin e komunitetit dhe fëmijëve për të drejtat dhe detyrimet. Këto fletëpalosje përdorin një gjuhë sa më të thjeshtë dhe të kuptueshme për të rinjtë dhe kanë qëllim mbrojtjen dhe parandalimin e përfshirjes në vepra penale. Gjithashtu, NJMF ka organizuar fushata ndërgjegjësuere në zona të ndryshme si, në zonën këmbësore të qytetit, njësive administrative, shkolla, familje të veçanta të cilat kanë fëmijë në rrisht braktisjeje.
- ✚ Bashkia Lezhë, ka realizuar 10 takime në shkolla të ndryshme dhe kanë marrë informacion rreth 240 fëmijë në lidhje me shërbimet e drejtësisë miqësore për fëmijë. Janë zhvilluar 7 takime periodike në komunitet dhe pjesëmarrës 115 prindër, të cilët janë informuar rreth parandalimit të përfshirjes së fëmijëve në vepra penale. Këto takime janë suportuar nga Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të ardhmen”, në mbështetje të UNICEF. Gjithashtu, mund të përmendim edhe realizimin e 4 aktiviteteve sportive në qendrat sociale të Bashkisë Lezhë me qëllim ndërgjegjësimin e fëmijëve dhe të rinjve mbi parandalimin e përfshirjes në kriminalitet dhe kanë qenë rreth 70 fëmijë.
- ✚ Bashkia Pogradec, gjatë periudhës 6-mujore janar-qershor, ka realizuar 9 aktivitete informuese / sensibilizuese me të rinj dhe fëmijë mbi tematika të ndryshme si parandalimi i akteve të dhunshme, diskriminimit racial. Gjatë periudhës janar-qershor, specialistët për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve kanë marrë pjesë në 4 trajnime të ndryshme për çështjet e të miturve për të ofruar shërbime të drejtësisë miqësore për fëmijët.
- ✚ Bashkia Pukë, ka kryer fushata ndërgjegjësuere në lidhje me trafikimin e fëmijëve të mitur, fushata ndërgjegjësuere për mosbraktisje të mësimin, aktivitete dhe lojëra zbatimëse, kampe verore në bashkëpunim me OJF.
- ✚ Takimet me familjet e fëmijëve zhvillohen në mënyre periodike për vlerësimet e problematikave sipas rasteve dhe mbështetjen e tyre në Bashkinë Shkodër. Në periudhën janar-maj 2024 janë zhvilluar trajnime me stafin PMF/NJMF për prindërimin pozitiv. Me 8 module të këtij trajnimit janë trajtuar tema të komunikimit prind-fëmijë, vlerësimi i nevojave të fëmijëve, respektimi i të drejtave të tyre etj. Kjo ka ndikuar në rritjen e kapacitetit të stafit dhe më pas këto module janë zhvilluar me grupe me prindërit dhe fëmijët me qëllim përmirësimin e nivelit të prindërimit.
- ✚ Bashkia Vlorë, ka zhvilluar një sërë aktivitete në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme, ku janë dhënë informacione në kuadër të parandalimit të kryerjes së veprave penale. Në periudhën Janar-Qershor 2024, janë kryer vizita vlerësuese pranë familjeve të fëmijëve me grupin social, ku gjatë vizitës është këshilluar familja si dhe fëmija për pasojat e veprës penale si dhe mënjanimi i veprave të tilla.
- ✚ Bashkia Tiranë, për vitin 2024 ka identifikuar nga skuadrat e terrenit 162 fëmijë në situatë rruge. Për secilin fëmijë dhe kujdestarët e tyre ligjorë u është dhënë informacioni mbi mbrojtjen nga shfrytëzimi ekonomik apo vepra të tjera penale. Gjithashtu, përgjatë muajit prill, muaji i fëmijëve në situatë rruge, punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve realizuan takime


në shkolla, komunitete dhe qendra komunitare mbi mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe trafikimi apo vepra të tjera penale.

➤ **Objektivi Specifik 1.2.**

Fuqizimi i mekanizmave të drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimit për parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve ku janë përfshirë fëmijë.

Plani i Veprimit për Objektivin 1.2 parashikon parashikon 2 masa, prej të cilave janë zbatuar pjesërisht. **100%** e masave janë zbatuar pjesërisht.

Objektivi Specifik 1.2: 2 masa



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara ■ Të pazbatuara

Arritjet kryesore më të rëndësishme për periudhën raportuese:

- ✚ Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve ka zhvilluar takime në shkolla për të promovuar programin e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimin në qytetet Elbasan, Durrës, Tiranë dhe Vlorë.

Dhoma ka zhvilluar aktivitete informuese, ndërgjegjësuere dhe promovuese me nxënësit dhe mësuesit për drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në shkolla në qytetet Lezhë dhe Shkodër.

Gjatë kësaj periudhë raportuese, janë përgatitur edhe kurrikulat e metodikave të ndërmjetësimit të konflikteve në shkolla. Si dhe janë trajnuar rreth 31 oficerë policie mbi adresimin e konflikteve për ndërmjetësimin dhe drejtësi restauruese.

Sfidat e hasura për realizimin e masave të qëllimit të Politikës I:

- ✚ Diskutimi i gjetjeve dhe sugjerimeve me aktorët kryesorë përgjegjës nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe institucionet e tjera me qëllim përmirësimet e nevojshme në programet mësimore.
- ✚ Zhvillimi i takimeve/diskutimeve me mësuesit nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve për mbledhjen e opinionit të tyre në lidhje me efektivitetin e programeve mësimore të lëndeve

të fushës “Shoqëria dhe mjedisi”, si dhe adresimi i gjetjeve dhe rekomandimeve të organet përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e programeve parauniversitare.


- ✚ Identifikimi dhe promovimi i rasteve të suksesit të nismave rinore dhe fëmijëve të integruar në shoqëri nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar.
- ✚ Emisione në mediat audiovizive (Radio Televisioni Shqiptar) me një gjuhë miqësore mbi kuptimin, zbatimin dhe promovimin e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve.
- ✚ Zhvillimi i konkurseve midis shkollave për promovimin e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimin në zgjidhjen e konflikteve nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve.

QËLLIMI I DYTË I POLITIKËS


“Një kuadër ligjor, institucional dhe me profesionistë që mundësojnë një drejtësi miqësore për çdo fëmijë”.

Qëllimi i Dytë i Politikës: 23 masa

23 masa të zbatueshme për 2024



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara
■ Të pazbatuara



Plani i Veprimit për Qëllimin e Dytë të Politikës parashikon 23 masa, prej të cilave 9 masa janë zbatuar plotësisht dhe 14 masa janë zbatuar pjesërisht. **39%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Plani i Veprimit parashikon 10 (dhjetë) masa për O.S 2.1, 11 (njëmbëdhjetë) masa për O.S 2.2 dhe 2 (dy) masa për O.S 2.3.


Masat ndjekin numërimin e planit të veprimit dhe janë me sfond me ngjyrë sipas nivelit të arritjes (*të zbatuara plotësisht/të zbatuara pjesërisht/të pazbatuara*).

➤ Objektivi Specifik 2.1

Kuadri ligjor dhe politikat institucionale garantojnë akses te një drejtësi miqësore për çdo fëmijë.

Plani i Veprimit për Objektivin 2.1 parashikon parashikon 10 masa, prej të cilave 3 masa janë zbatuar plotësisht dhe 7 masa rezultojnë të zbatuara pjesërisht. **30%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 2.1: 10 masa



Arritjet kryesore për periudhën raportuese:


- ✚ Gjatë periudhës së raportimit, Avokati i Popullit ka adresuar 14 rekomandime me objekt mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve dhe 10 nënrekomandime për garantimin e të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin.
- ✚ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka trajtuar 38 ankesa me subjekte fëmijët në fushën e të mirave dhe shërbimeve.

➤ **Objektivi Specifik 2.2**

Koordinimi dhe bashkërendimi mes institucioneve me qëllim forcimin e kapaciteteve të profesionistëve që punojnë me dhe për fëmijët.

Plani i Veprimit për Objektivin 2.2 parashikon parashikon 11 masa, prej të cilave rezulton se 5 masa janë të zbatuara plotësisht dhe 6 masa janë të zbatuara pjesërisht. **45%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 2.2: 11 masa



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara ■ Të pazbatuara

Arritjet kryesore për periudhën raportuese:


- Drejtoria e Përgjithshme Policisë së Shtetit në bashkëpunim me UNICEF, ka zhvilluar gjatë muajit Maj 2024, trajtime 3-ditore në qarqet Lezhë, Vlorë dhe Tiranë me temë "Teknikat shkencore të intervistimit me të mitur" me pjesëmarrjen të 170 punonjësve të policisë.
- Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me Terre des Hommes, kanë organizuar disa trajnime. Qëllimi i trajnimeve ishte fuqizimi i profesionistëve të ligjit me teknikat miqësore të intervistimit të të miturve, viktimat të dhunës fizike dhe abuzimit seksual. Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin 62 profesionistë (prokurorë, oficerë, koordinatorë) nga të gjithë prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm.
- Shkolla e Magjistraturës ka organizuar 6 trajnime në kuadër të drejtësisë për të mitur në çështjet penale, civile, familjare dhe administrative ku fëmija merr pjesë ose vendimmarrja e tyre ndikon te fëmija.
- Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka marrë pjesë në trajnime të organizuara nga partnerë vendas dhe ndërkombëtare, si IPO, UNICEF, OSCE, CFD, etj., në kuadër të forcimit të kapaciteteve të punonjësve të Qendrës.
- Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, gjatë gjashtë mujorit të parë në bashkëpunim me Qendrën e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, ka organizuar trajnime në bashkitë Dibër, Gjirokastrë dhe Malësi të Madhe, në bashkitë të cilat Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës kanë menaxhuar raste fëmijësh në konflikt me ligjin. Trajnimet janë zhvilluar me NJMF dhe aktorët vendor të cilët janë pjesë e GTN.

➤ Objektivi specifik 2.3

Forcimi i rolit koordinues të Ministrisë së Drejtësisë për çështjet që lidhen me fëmijët dhe mbledhja, përpunimi dhe publikimi i statistikave për çështjet civile, familjare, administrative dhe penale ku fëmijët janë pjesë ose vendimmarrja ndikon te fëmijët, bazuar në standardet ndërkombëtare të miratuara në fushë.

Plani i Veprimit për Objektivin 2.3 parashikon parashikon 2 masa prej të cilave rezultojnë se 1 masë është e zbatuar plotësisht dhe 1 masë është e zbatuar pjesërisht. **50%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 2.3: 2 masa



Arritjet kryesore për periudhën raportuese:

- ✚ Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, për vitin 2024, ka bërë të mundur ndarjen për çështjet civile, familjare, administrative dhe penale ku fëmijët janë pjesë ose vendimmarrja ndikon tek fëmijët, kur ndihma juridike përfitohet nga të miturit. Për periudhën janar- qershor kanë përfituar në total 146 të mitur, ku 87 raste janë çështje administrative, 15 penale, 24 civile dhe 20 janë të papërcaktuar se cilës lloji çështje i përkasin.
- ✚ Ndhimja Juridike Falas shprehet se nga administrimi dhe analiza e të dhënave rezultojnë se gjatë periudhës janar – qershor 2024, kanë përfituar në total 146 të mitur ndihmë juridike parësore dhe nuk është administruar asnjë rast që i përket ndihmës juridike dytësore (përfitimi i avokatit, psikologut etj).
- ✚ Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka përgatitur dhe hartuar Raportin 6-mujor për periudhën Janar - Qershor 2024 për Ministrinë e Drejtësisë, mbi funksionimin e Sistemit të Integruar, situatën e hedhjes së të dhënave si dhe problematikat dhe rekomandimet në vazhdimësi për një mbarëvajtje dhe funksionim efektiv të sistemit. Situata e hedhjes së të dhënave në sistem nga institucionet përgjegjëse si Polici, Prokurori, Shërbimi Prove, IEVP për të mitur Kavajë, Gjykatë deri në datë 1 korrik 2024, rezultojnë e pasqyruar në një panoramë të përgjithshme. Në sesionin “Të Mitur”, nga ku gjenerohet raporti për të gjitha rastet e hedhura në Sistemin e Integruar nga institucionet përdoruese për periudhën Janar - Qershor 2024 rezultojnë që janë hedhur 5,340 raste.

Sfidat e hasura për realizimin e masave të qëllimit të Politikës II:

- ✚ Hartimi i një modeli të unifikuar të të dhënave të profesionistëve të trajnuar/specializuar në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse.
- ✚ Ambiente të nevojshme në gjykata për tu përshtatur në mjedise miqësore për të miturit për shkak të hartës së re gjyqësore, e cila ka sjellë si rezultat rritjen e stafëve organike për të cilat godinat e gjykatave nuk ofrojnë sipërfaqet e nevojshme të punës.


- ✚ Fonde në buxhetin e disa institucioneve (DPP, SHP) për trajnimin e punonjësve në fushën e drejtësisë penale për të mitur.
- ✚ Aksesit i kufizuar i Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve në Sistem pasi shpesh herë nuk lejon marrjen e të dhënave statistikore të hedhura nga institucionet përgjegjëse, sipas indikatorëve përkatës.

QËLLIMI I TRETË I POLITIKËS


“Garantimi i qasjes në çdo kohë në drejtësinë miqësore për çdo fëmijë. Garantimi i qasjes në çdo kohë në drejtësinë miqësore për çdo fëmijë”.

Qëllimi i Tretë i Politikës: 10 masa

10 masa të zbatueshme për vitin 2024



- Plotësisht të zbatuara
- Pjesërisht të zbatuara
- Të pazbatuara



Plani i Veprimit për Qëllimin e Tretë të Politikës parashikon 10 masa, prej të cilave 4 masa janë zbatuar plotësisht dhe 6 masa janë zbatuar pjesërisht. **40%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Plani i Veprimit parashikon 2 (dy) masa për O.S 3.1, 5 (pesë) masa për O.S 3.2 dhe 3 (tre) masa për O.S 3.3.


Masat ndjekin numërimin e planit të veprimit dhe janë me sfond me ngjyrë sipas nivelit të arritjes (*të zbatuara plotësisht/të zbatuara pjesërisht/të pazbatuara*).

➤ Objektivi Specifik 3.1

Qasje për çdo fëmijë në ndihmën juridike të ofruar nga profesionist të trajnuar dhe informacioni me gjuhë miqësore për çdo fëmijë.

Plani i Veprimit për Objektivin 3.1 parashikon parashikon 2 masa, prej të cilave 2 masa janë zbatuar plotësisht. **100%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 3.1: 2 masa



Arritjet kryesore për periudhën raportuese:

- Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas ka miratuar kalendarin e planeve të aktiviteteve për sa i përket fushatave ndërgjegjësuese/promovuese, mbikëqyrje operative si dhe monitorimi i ofruesve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore.


Ndihma Juridike Falas në faqen e saj zyrtare si dhe në rrjetet sociale ka publikuar një informacion ligjor mbi përfitimin e ndihmës juridike, në një formë të thjeshtë dhe të kuptueshme nga të miturit si dhe nga personat e tjerë kategori përfituese e ligjit. Drejtorja gjithashtu harton Buletinin Mujor (newsletter). Ky buletin përbën një risi për institucionin dhe ka si qëllim informimin e të gjithë qytetarëve dhe aktorëve bashkëpunues mbi aksesin në drejtësi dhe aktivitetet e zhvilluara nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike falas. Gjithashtu, janë zhvilluar takime në ambientet e shkollave nga punonjësit me trajnim të posacëm të 20 Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore. Për 6 mujorin e parë të 2024, janë zhvilluar trajnime dhe praktika 2-mujore të studentëve të angazhuar pranë Klinikave të Ligjit, të cilët janë informuar mbi ofruesit e ndihmës juridike falas, kushtet për përfitimin e ndihmës juridike falas, kategoritë përfituese si dhe procedurën e dhënies së ndihmës juridike falas. Një fokus të vecantë, gjatë trajnimeve/praktikave me studentët, është theksuar dhe tek të miturit, duke treguar kujdes të shtuar në mënyrën e pritjes dhe evidentimit të problematikave të tyre, për tu bërë i mundur realizimi i të drejtave të tyre, si përfitues të drejtëpërdrejtë të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

➤ Objektivi Specifik 3.2

Shërbime të drejtësisë miqësore për çdo fëmijë të ofruara në mjedise të aksesueshme për ta.

Plani i Veprimit për Objektivin 3.2 parashikon parashikon 5 masa, prej të cilave 1 masë është zbatuar plotësisht dhe 4 masa janë zbatuar pjesërisht. **20%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 3.2: 5 masa



Arritjet kryesore për periudhën raportuese:


- ✚ Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në bashkëpunim me UNICEF, ka përgatitur Manualin për "Teknikat Shkencore të Intervistimit me të mitur" dhe ka shpërndarë në rrugë elektronike tek punonjësit e Policisë së Shtetit që ishin pjesë e trajnimeve të kryera, nga gjitha drejtoritë vendore të policisë në vend.
- ✚ Këshilli i Lartë Gjyqësor raporton se përcaktimi i standardeve të mjediseve miqësore dhe të përshtatshme për fëmijët në gjykata, përfshirë personat me aftësi të kufizuara janë të plotësuar nga gjykatat, por plotësimi dhe përmirësimi i këtyre standardeve do të zbatohet konkretisht për ato gjykata të cilat janë parashikuar të ndërtohen godina të reja për shkak të hartës së re gjyqësore.
- ✚ Prokuroria e Përgjithshme ka krijuar ambiente miqësore për të mitur në prokurori që pas hyrjes në fuqi të KDPM, por është në plan përmirësimin i këtyre ambienteve sipas standardeve ndërkombëtare dhe hartës së re gjyqësore. Sa herë vlerësohet e nevojshme nga prokurori dhe në çdo rast kur ligji parashikon intervistimin me audio video të të miturit, intervistimi kryhet në ambientet e krijuara në komisarite, të cilat ofrojnë standardet e nevojshme, për të shmangur kontaktet dhe ballafaqimin e fëmijës me autorin e veprës penale.

➤ Objektivi Specifik 3.3

Shërbime mbështetëse të standartizuara, të arritshme për çdo fëmijë.

Plani i Veprimit për Objektivin 3.2 parashikon parashikon 3 masa, prej të cilave 1 masë është zbatuar plotësisht dhe 2 masa janë zbatuar pjesërisht. Periudha e dytë e vitit do të sjellë një progres të këtij objekti. **33%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 3.3: 3 masa



Arritjet kryesore për periudhën raportuese:

- Në zbatim të dispozitave ligjore si dhe në ushtrimin e kompetencave të saj, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit, ka marrë masat dhe ka iniciuar procedurën për plotësim të 7 (shtatë) vendeve vakante për përmbartues gjyqësorë shtetëror, sipas organikës aktuale të shërbimit. Gjithashtu, në kuadër të forcimit dhe konsolidimit të shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror është kërkuar shtim i organikës së këtij shërbimi duke propozuar dhe kërkuar konkretisht shtim të burimeve njerëzore, shtim të psikologut dhe punonjësit social në strukturë, shtim të stafit mbështetës si dhe shtim të përmbartuesve gjyqësor shtetëror.
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit raporton se asistimi me psikolog dhe punonjës social për çështjet me të mitur bëhet nga psikologët e OJF-ve me të cilët Policia e Shtetit ka bashkëpunim dhe psikolog nga Urdhri i Psikologut. Gjatë periudhës raportuese, është përgatitur lista e përgjithshme e punonjësve social që i vjen në ndihmë procedurave të Policisë së Shtetit në rastet me të mitur. Kjo listë është shpërndarë tek të gjithë strukturat vendore të Policisë së Shtetit.

Sfidat e hasura për realizimin e masave të qëllimit të Politikës III:


- Përmirësimi i shërbimeve në gjykata dhe prokurori, për fëmijët në kontakt/konflikt me ligjin, për të ofruar mjedise miqësore në godinat e reja, sipas hartës gjyqësore të miratuar.
- Fonde për sigurimin e ambjenteve të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të SHP dhe institucioneve të saj të varësisë.
- Fonde për përshtatje të ambjenteve me mjedise miqësore për fëmijë në buxhetin e shërbimit të përmbartimit gjyqësor shtetëror.

Qëllimi i Katërt i Politikës


Drejtësi penale që mundëson parandalimin e ripërfshirjes së fëmijës në kryerjen e veprave penale, rishoqërimin dhe ri-integrimin e fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin.

Qëllimi i Katërt i Politikës: 19 masa

19 masa të zbatueshme për vitin 2024



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara
■ Të pazbatuara



Plani i Veprimit për Qëllimin e Katërt të Politikës parashikon 19 masa, prej të cilave 10 masa janë zbatuar plotësisht, 9 masa janë zbatuar pjesërisht. **53%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Plani i Veprimit parashikon 4 (katër) masa për O.S 4.1, 3 (tre) masa për O.S 4.2, 7 (shtatë) masa për O.S 4.3, 3 (tre) masa për O.S 4.4 dhe 2 (dy) masa për O.S 4.5.


Masat ndjekin numërimin e planit të veprimit dhe janë me sfond me ngjyrë sipas nivelit të arritjes (*të zbatuara plotësisht/të zbatuara pjesërisht/të pazbatuara*).

➤ **Objektivi Specifik 4.1.**

Zgjerimi i mundësive të mbikqyrjes së fëmijëve në konflikt me ligjin, përmes shmangies nga ndjekja penale/dënimi.

Plani i Veprimit për Objektivin 4.1 parashikon parashikon 4 masa, prej të cilave 1 masë është zbatuar plotësisht dhe 3 masa janë zbatuar pjesërisht. **25%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 4.1: 4 masa



Arritjet kryesore për periudhën raportuese:


- ✚ Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare, ka organizuar disa trajnime në kuadër të zbatimit të masave alternative të mundshme për shmangien nga ndjekja penale dhe referimi në programet e drejtësisë restauruese, në të cilën kanë marrë pjesë magistratë në detyrë dhe profesorë.

➤ Objektivi Specifik 4.2

Programe të drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimit të mundësuar për fëmijën në konflikt me ligjin ose viktimë e krimit, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.

Plani i Veprimit për Objektivin 4.2 parashikon parashikon 3 masa, 2 masa prej të cilave janë zbatuar plotësisht dhe 1 masë është zbatuar pjesërisht. **67%** e masave janë zbatuar pjesërisht.

Objektivi Specifik 4.2: 3 masa



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara ■ Të pazbatuara

Arritjet kryesore për periudhën raportuese:


- ✚ Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve ka organizuar 2 trajnime që lidhen me drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin, në të cilën janë trajnuar punonjës policie nga gjithë struktura vendore e policisë.
- ✚ Prokuroria e Përgjithshme raporton se gjatë periudhës janar- qershor 2024, nga të dhënat statistikore të prokurorive rezulton të jetë aplikuar ndaj 7 të miturve këshillimi si masë shmangie, por nuk rezulton të jetë aplikuar ndaj të miturve ndërmjetësimi si masë shmangie, si dhe nuk janë aplikuar masa detyruese (nga statistikatat nuk identifikohet dot lloji i masës).

➤ Objektivi Specifik 4.3

Struktura mbikëqyrëse që garantojnë trajtimin miqësor, rishoqërizimin, rehabilitimin e fëmijës në konflikt me ligjin.

Plani i Veprimit për Objektivin 4.3 parashikon parashikon 7 masa, 4 prej të cilave janë zbatuar plotësisht dhe 3 janë zbatuar pjesërisht. **57%** e masave janë zbatuar pjesërisht.

Objektivi Specifik 4.3: 7 masa



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara ■ Të pazbatuara

Arritjet kryesore për periudhën raportuese:

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve raporton se për 6 mujorin e parë të vitin 2024, është hartuar 1 kurrikul e re si dhe janë rishikuar 3 programe. Programet që ofrohen në institucionet e IEVP-së bazohen në kërkesat që kanë individët në këto institucione. Në kuadër të zhvillimit të veprimtarive të përbashkëta të teknikave të prindërimit pozitiv të fëmijëve me qëllim forcimin e rolit të tyre në rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijëve, janë kryer takime periodike mes të miturve, familjes dhe ekspertëve të Caritas nga IM Kavajë. Gjatë periudhës raportuese në bashkëpunim me CARITAS është miratuar manuali mbi për detyrat e punonjësi të angazhuar në veprimtari e rekreacionit të fëmijëve në konflikt me ligjin. Njëpunjet këtij bashkimi janë trajtuar edhe punonjësit e IM Kavajë. Gjithashtu, Drejtoria ka hartuar dhe miratuar Protokollin e Mekanizmit për referim për riintegrim në shoqëri të të miturve dhe të rinjve në konflikt me ligjin, ku përshkruhen detyrimet dhe përgjegjësitë e institucioneve të përfshira në këtë proces.
- Për vitin 2024, në kuadër të riintegrit të të miturve pas kryerjes së dënimit, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me 3 OJF dhe institucione që veprojnë në fushën e drejtësisë penale për të mitur me; "Klubin Sportiv Partizani"; "Federatën Shqiptare Regby" dhe me shoqatën "OrArt". Nga ana e Qendrës është vijuar me punën sa i takon ndjekjes së ecurisë së rasteve të suksesshme të të miturve të cilët janë trajtuar me programe riintegrimi pas vuajtjes së dënimit. Një nga të miturit që ka përfunduar dënimin në IM Kavajë ka ndjekur kursin profesional.
- Shërbimi i Provës ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi, përkatësisht me: Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Shoqatën Community Aid, Shoqatën Antigonea dhe me 62 Bashki në Republikën e Shqipërisë, si dhe marrëveshjen e bashkëpunimit me Qendrën për Zhvillim Kombëtar "Sot Për Të Ardhmen".
- Për 6 mujorin e parë të vitit 2024, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka realizuar 10 takime me përfaqësuesit e NJMF-ve, në qytetet Tiranë, Durrës, Lezhë, Shkodër, Korçë, Fier, gjithashtu edhe takime të shumta në IM Kavajë.

Bashkëpunimi ka qenë efektiv në trajtimin e rasteve sipas detyrimeve ligjore. Si dhe janë realizuar 15 fushata informuese me nxënësit e arsimit parauniversitar.


- ✚ Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve raporton se informimi i fëmijës dhe familjarëve të tij për përfitimet nga programet rehabilituese/riintegruese kryhet rregullisht nga IM Kavajë.

➤ **Objektivi Specifik 4.4**

Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka kapacitetet e duhura në fushën e parandalimit të ripërfshirjes së të miturit në kryerjen e veprave penale.

Plani i Veprimit për Objektivin 4.3 parashikon parashikon 3 masa, 2 prej të cilave janë zbatuar plotësisht dhe 1 është zbatuar pjesërisht. **67%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 4.4: 3 masa



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara ■ Të pazbatuara

Arrijtjet kryesore për periudhën raportuese:


- ✚ Në kuadër të përmirësimit të politikave penale në fushën e parandalimit të përfshirjes në krime të fëmijëve dhe të rinjve, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve në bashkëpunim me ekspertë të drejtësisë penale ka promovuar librin "Nevojat e të Miturve në Konflikt me Ligjin dhe Përshtatja e Programit Rehabilitues. Ndërthurja e Analizës dhe Veprimit". Gjithashtu, ka bashkëpunuar me UNICEF, me qëllim ofrimin e mbështetjes dhe asistencës për institucionet përgjegjëse në përdorimin e Sistemit të Integruar, si dhe trajnimin e të gjithë përdoruesve sipas nevojave të institucioneve, ku është përfshirë dhe administratori dhe mbikëqyrësit e sistemit nga të gjitha institucionet.
- ✚ Në kuadër të mirëfunksionimit dhe zhvillimit të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, Qendra përgjatë periudhës Janar – Qershor 2024, ka organizuar një takim me mbikëqyrësit e Sistemit në muajin maj, pasi sistemi filloi të funksionojë duke bërë bashkë të gjithë institucionet përdoruese të këtij sistemi përfshirë Shërbimin e Provës, Policinë, Prokurorinë, Gjykatën si dhe ekspertët e kontraktuar nga UNICEF.

➤ Objektivi Specifik 4.5

Fuqizimi i rrjetit të bashkëpunimit ndërinstitucional të profesionistëve që punojnë me dhe për fëmijën.

Plani i Veprimit për Objektivin 4.4 parashikon parashikon 2 masa, 1 prej të cilave është zbatuar plotësisht dhe 1 është zbatuar pjesërisht. **50%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 4.5: 2 masa



Arrijet kryesore për periudhën raportuese:


- ✚ Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve për 6 mujorin e parë të vitit 2024 ka zhvilluar 10 takime me punonjës të mbrojtjes së fëmijës dhe aktorë të tjerë lidhur me të miturit në konflikt me ligjin për të diskutuar problematikën që hasen në menaxhimin e rasteve konkrete dhe adresuar zgjidhjen e tyre.

Sfidat e hasura për realizimin e masave të qellimit të Politikës IV:

- ✚ Mos koordinimi në legjislacion që institucionet mund të kenë referuar detyrave të tyre funksionale ka sjellë që brenda periudhës raportuese të mos hartohet udhëzuesi në lidhje me përmbushjen e përgjegjësisë nga çdo institucion i përfshirë në trajtimin e rastit.
- ✚ Burime njerëzore për zhvillimin e sa më shumë fushatave ndërgjegjësuese në shkolla.
- ✚ Rritja e trajnimeve për punonjësit e QPKMR nga institucionet shtetërorë pasi trajnimet e ofruara zhvillohen nga organizata jofitimprurëse ose partner.
- ✚ Akses i kufizuar i sitemit si shkak i mosfunksionimit të tij, e cila sjell pamundësinë e hartimit të raporteve sipas afateve të përcaktuar në kuadër të mbledhjes të të dhënave nga institucionet përkatëse që trajtojnë raste me të mitur.

V. NIVELI I REALIZIMIT NË TOTAL PËR 64 MASA NË PERIUdhËN JANAR-QERSHOR 2024

Niveli i realizimit në total për 64 masa:



Plani i Veprimit, për periudhën janar-qershor, parashikon 64 masa në të cilat institucionet përgjegjëse raportojnë progresin përfshirë masat të cilat raportohen rregullisht dhe masat të cilat fillojnë zbatimin e tyre gjatë vitit 2024.

Gjatë periudhës raportuese janar-qershor 2024, **47%** e masave janë zbatuar plotësisht, **51%** e masave janë zbatuar pjesërisht dhe **2%** e masave janë të pazbatuara.

➤ Vlerësimi i sfidave, hapat në vijim

Mbështetur në rezultatet e monitorimit të kryer për periudhën *1 janar – 30 qershor 2024*, rezultojnë se institucionet kanë treguar performancë të mirë për këtë periudhë raportimi por ende ka aktivitete të porealizuara/pazbatuara/paraportuara.

Në adresimin e performancës nga institucionet, rezultojnë se mungesa e burimeve njerëzore specifike (kapacitete institucionale); mungesa e buxheteve specifike për kryerjen e disa veprimtarive të parashikuara; janë arsye dhe shkaqe që kanë çuar në mosrealizim të objektivave të parashikuara për periudhën e raportimit.

Me qëllim përmirësimit të zbatimit dhe rritjes së impaktit të Planit të Veprimit 2023-2024, sfidat e rëndësishme për periudhat vijuese të zbatimit dhe të monitorimit janë:

- ✚ Informacioni i raportuar duhet të përpunohet dhe dërgohet në përputhje me masën e caktuar për zbatim, të jetë faktik, të ketë evidenca të qarta dhe të dhëna analitike. Çdo qëllim politikash duhet të ndërlidhet me nivelin e zbatueshmërisë së masave/aktiviteteve dhe buxhetin e planifikuar dhe të buxhetit faktik të përdorur.
- ✚ Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve përgjegjëse të përfshira në Planin e Veprimit lidhur me rëndësinë që paraqet puna e vazhdueshme për zbatimin e duhur dhe në kohë të PV, si dhe mbi rëndësinë e procesit të raportimit.
- ✚ Rritja e nivelit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga strukturat e brendshme të institucioneve përgjegjëse edhe nëpërmjet fuqizimit të koordinimit ndërinstitutional.
- ✚ Rakordimi i informacionit të marrë nga pikat e kontaktit tek Drejtoritë e Financës, përpara momentit të raportimit.
- ✚ Kryerja e procesit të monitorimit periodik, diskutimit të gjetjeve dhe miratimit të raporteve respektive sipas afateve të raportimit të parashikuara në Strategji.

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën *janar - qershor 2024*, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që institucionet kanë raportuar dhe të analizës së kryer, kërkohet që:

- ✚ Të vijojë zbatimi i masave në statusin “zbatuar pjesërisht/në proces” sipas afateve të parashikuara;
- ✚ Të nisë zbatimi në kohë i masave/aktiviteteve të parashikuara për periudhën në vijim;
- ✚ Të tregohet kujdes për organizimin e punës dhe proceseve përkatëse për ecurinë e masave e aktiviteteve;
- ✚ Të sigurohet operativiteti i burimeve dhe kapaciteteve njerëzore dhe ekspertizës së nevojshme për kryerjen e tyre;
- ✚ Dërgimi i informacionit mbi disbursimin financiar për aktivitetet e parashikuara në strategji, pasi ndikojnë në pasqyrimin jo real të kostove për zbatimin e Strategjisë;
- ✚ Të sigurohet bashkëpunimi institucional i nevojshëm për masa e aktivitete të përbashkëta;
- ✚ Të garantohet koordinimi i mjaftueshëm për të shkëmbyer në mënyrë të efektshme informacionin dhe zgjidhur problemet penguese që mund të zgjidhen nga institucionet (përgjegjëse dhe bashkëpunëtore).